

BACHELOR NË “MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE”

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i njeh studentët me bazat e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, duke u ofruar atyre njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të kuptuar dhe analizuar ngjarjet në rendin global. Gjatë rrugëtimit të tyre akademik studentët kanë mundësinë të specializohen në dy profile të veçanta në përputhje me interesat e tyre akademike si Siguria dhe Studimet Europiane. Në profilin Siguri, studentët thellohen në tema si konflikti ndërkombëtar, politika e mbrojtjes dhe sfidat e sigurisë globale, ndërsa tek Studimet Europiane fokusohen në dinamikat politike, ekonomike dhe kulturore brenda Evropës, duke përfshirë rolin e Bashkimit Europian në çështjet globale. Ky program Bachelor, thekson njohuritë teorike dhe aftësitë praktike, duke përgatitur studentët të bëhen pjesëmarrës të informuar, të përshtatshëm dhe proaktivë në arenën politike.

REZULTATET E TË NXËNIT

Pas përfundimit me sukses të programit, studentët janë në gjendje të:

- Kuptojnë dhe lidhin teoritë dhe pasjet kyçe në Marrëdhëniet Ndërkombëtare: kuptojnë idetë thelbësore në marrëdhëniet ndërkombëtare, duke përfshirë përdorimin e fuqisë në nivelin global dhe ndërveprimet mes shteteve dhe aktorëve jo-shtetërorë.
- Kuptojnë ngjarjet aktuale ndërkombëtare dhe aplikojnë teoritë bashkëkohore për të analizuar.
- Vlerësojnë dhe sintetizojnë informacionin: zhvillojnë aftësinë për të vlerësuar në mënyrë kritike dhe sintetizuar informacionin nga burime të ndryshme dhe të besueshme, dhe dallojnë burimet primare dhe sekondare.
- Zhvillojnë argumente logjike dhe analizë kritike: kultivojnë aftësinë për të ndërtuar argumente logjike dhe të arsyetojnë qëndrimet mbi tema të ndryshme përmes prezantimeve të shkruara dhe të folura.

PROFILI: SIGURI

- Kuptojnë në mënyrë të përgjithshme teoritë kyçe dhe të nën-fushave të marrëdhënieve ndërkombëtare, me një fokus të veçantë në studimet e sigurisë.
- Identifikojnë dhe kuptojnë rolet dhe funksionet e aktorëve dhe institucioneve kryesore në marrëdhëniet ndërkombëtare në nivelet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare.
- Analizojë çështjet e sigurisë ndërkombëtare nga perspektiva të ndryshme, duke përfshirë korniza të ndryshme teorike dhe metodologjike.
- Kuptojnë rëndësinë dhe implikimet e kulturave dhe gjuhëve të huaja në kontekstin e sigurisë ndërkombëtare.

PROFILI: STUDIME EUROPIANE

- Kuptojnë proceset e integrimit dhe vendimmarrjes së BE.
- Vlerësojnë në mënyrë kritike, të pavarur dhe i komunikojnë efektivisht çështjet e diskursit publik të BE-së.



maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



- Njohin në thellësi procesin e integritetit evropian, duke përfshirë dimensionet e tij ekonomike, politike, institucionale, historike dhe ligjore dhe kuptojnë nivelet e ndryshme të ushtrimit të pushtetit politik brenda BE-së.

MUNDËSITË E PUNËSIMIT

Të diplomuarit kanë mundësi të punësohen në sektorë që lidhen me marrëdhëniet ndërkombëtare:

- Specialistë në institucione të administratës qendrore dhe lokale.
- Nëpunës i shërbimit diplomatik në ambasada, konsullata dhe misione diplomatike.
- Specialistë, konsulentë dhe koordinatorë projektsh/ programesh në organizata ndërkombëtare dhe OJF.
- Gazetar/analist i çështjeve ndërkombëtare dhe europiane/ korrespondent i lajmeve.
- Asistent kërkues dhe analist në kompani kërkimore, *think tanks* ose institucione akademike.



**Universiteti
European i
Tiranës**

maiora premunt / gjëra të mëdha na presin



BACHELOR "MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE" 180 ECTS

Nr.	Viti	Sem	Emri i lëndës	ECTS
-----	------	-----	---------------	------

A - Lëndë Bazë/ 15-20%/32 ECTS

1	I	1	Hyrje në filozofi	6
2	I	1	Hyrje në sociologji	6
3	II	1	Hyrje në ekonomi	6
4	I	1	Shkrim akademik dhe Metoda kërkimi	8
5	I	2	Statistikë	6
				32

B - Lëndë karakterizuese 50-55%/98 ECTS

1	I	2	Histori bashkëkohore	6
2	I	2	Hyrje në shkenca politike	8
3	I	2	Hyrje në marrëdhënie ndërkombëtare	8
4	II	1	Politikë e krahasuar	6
5	II	1	Teoritë e marrëdhënies ndërkombëtare	10
6	II	2	Filozofia e së drejtës	6
7	II	2	E drejtë kushtetuese	6
8	II	2	Bazat e diplomacisë	8
9	III	1	Komunikim politik	8
10	II	1	E drejtë ndërkombëtare publike I	6
11	II	2	E drejtë ndërkombëtare publike II	6
12	III	1	Gjeopolitikë	6
13	III	2	Historia politike e Shqipërisë	8
14	I	2	E folura në publik	6
				98

C - Lëndë ndërdisiplinore/integruese /12-15%/24 ECTS

PROFIL I			SIGURI	
1	II	2	Çështje të sigurisë	6
2	III	2	Studime rajonale	6
3	III	2	Organizatat ndërkombëtare	6
4	III	1	Komunikim ndërkulturore	6
5	II/III	1-2	Honors Course	6
PROFIL II			STUDIME EUROPIANE	
1	II	2	Historia e Integritit dhe Institucionet e BE	6
2	III	2	Politikat e BE-së	6
3	III	2	Organizatat ndërkombëtare	6
4	III	1	E drejta e Bashkimit Europian	6
5	II/III	1-2	Honors Course	6
				24

D - Lëndë plotësuese 10-15% /20 ECTS

1	I	1	Anglisht B1	5
2	I	1	Bazat e informatikës	4
3	III	1	Hartim dhe menaxhim projektsh	6
4	III	2	Praktikë dhe zhvillim karriere	5
				20

E - Detyrime përmbyllëse 3-5%/7 ECTS

1	III	2	Punimi i diplomës/Provimi i përgjithshëm përfundimtar	7
---	-----	---	---	---